ARNISA BAXHA

SI ERA

ROMAN

BOTIMET TOENA

Arnisa Baxha

SI ERA

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi
Korrektore letrare: Anjeza Hoda
Përkujdesja grafike: Rogen Alushani
Kopertina:

ISBN 9789928961082

©AUTORJA & BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollesha”, nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
https://toena.al

Për Amosin dhe Elian

RRËFIMI I ROZAFËS

Nën iluzionin
se një grua vlen më pak se një burrë,
më murosën mua.
Nën idenë
se u ushqye me gjakun tim,
Kalaja gjeti forca të mbahej në këmbë.
Nën sikletin
se mund të thirrej dëshmitar,
Drini vazhdoi udhën.
Nën emblemën
e vetësakrificës njerëzore,
më kthyen në legjendë.
Nën pretekstin
se të gjithë patën të drejtë,
edhe unë murosa brenda vetes fjalën "vrasje".

GJEKË MARINAJ

Ky libër bazohet në një mace të vërtetë.
Çdo personazh tjetër është fryt i fantazisë dhe çdo afërsi me situata të përshkruara është rastësore.

PROLOG

Tiranë, 2015

Gjithmonë kam pasur një frikë të çuditshme dhe të pashpjegueshme nga gjilpërat. Ndoshta sepse dikur, kur isha 8 vjeçe, nuk e di si pata dëgjuar se nëse shkel mbi një të tillë, pa e kuptuar aspak, ajo mund të futej në lëkurë dhe, drejt e nga aty, të depërtonte në damarë, e përmes gjakut që rrjedh furishëm, të qarkullonte pa asnjë pengesë deri në zemër.

Pa qenë në gjendje të ndieje dhimbje, ajo gjë e vogël do të ngulitej thellë, dhe ashtu krejt papritur, zemra do të pushonte së rrahuri. Dhe aq do të ishte jeta jote.

Për net të tëra, kur të gjithë binin për të fjetur, rrija në heshtje duke numëruar gjilpërat që kishim në shtëpi, në një kuti të vogël me ngjyrë blu. Shtatë të tilla, saktësisht, pa numëruar ato me kokë, pasi atyre nuk ua kisha aq shumë frikën. Vetëm pasi sigurohesha që të shtatat ndodheshin në vendin e tyre, vetëm atëherë mund të flija e qetë, e bindur se nuk do të vdisja. Derisa një natë më dolën gjashtë. I numërova përsëri, me shpresën se mos isha ngatërruar, por jo, përsëri gjashtë.

– Po tani? – mendova me vete. Kërkova si e çmendur nëpër shtëpi, edhe pse nuk gjeta asgjë. A thua se gjendet gjilpëra e humbur?!

Vendosa të shtrihem në shtrat atë natë dhe të pres, me sy hapur, derisa e shtata të më çonte në një botë tjetër. Jo vetëm gjilpërat ishin një fobi për mua, të tilla ishin; lartësitë, ambientet e mbyllura, ato të hapurat, meshkujt e dashuria. Ndonjëherë edhe vetë koncepti i të qenit e lumtur, më trembte

Sikur, nëse në një moment të vetëm të ndihesha e lumtur, me siguri ai moment do të pasohej nga diçka e keqe. Prandaj, mbajtja e një gjendjeje konstante apatie, trishtimi apo vetmie më jepte një ndjesi sigurie.

Ishte e pamundur të flisja me nënën time. E imagjinoj edhe tani: nëse do të përpiqesha t'i shpalosja imagjinatën time të shfrenuar, frikërat dhe pasiguritë e mia, e di si do të më shikonte, me ata sytë e saj të zgurdulluar, si atë ditë kur vendosa t'i them se ndieja një trishtim të thellë në zemër, se kjo botë më dukej tepër e padrejtë dhe se nuk e dija nëse do të mund të rritesha ndonjëherë.

Shpërtheu në të qeshur, sikur ajo që sapo kisha thënë të mos ishte asgjë më shumë se një dalldisje fëminore. Por, thellë-thellë, e kuptova: ajo kishte frikë nga mendimet e mia. Dhe ndoshta edhe unë duhet të kisha. Prandaj, që nga ajo ditë, vendosa t'i mbaj vetëm për vete.

E ndieja se më konsideronin të çuditshme dhe të frikshme, apo thjesht si një fëmijë që mendon më shumë se ç'duhet. E gjeja veten me orë të tëra në dhomën time, ulur te pragu i dritares, me shikimin e tretur diku në qiell. Nga dritarja mund të shihje tre bredha të lartë që lëkundeshin nga era. Ishte qetësi. Ishim unë dhe mendimet e mia, të cilat, pavarësisht gjithçkaje, gjenin lirinë e munguar, kuptimin e vërtetë, vendin e tyre.

Mbaj mend të kisha vendosur dhe një tabelë te dera me shënimin me të kuqe "Mos më shqetëso!", edhe pse do kisha preferuar një çelës nga brenda në mënyrë që të kontrolloja unë kush vinte apo thjesht të dilja kur kisha nevojë, por nuk e di pse, e vetmja derë e shtëpisë që nuk lejohej të kishte çelës, ishte e imja. E kishin më se të qartë të dy ata, mami dhe babi, që nuk doja të rrija me ta.

Ne ishim një familje e çuditshme tani që e mendoj. Nuk mbaj mend të kemi ngrënë drekë apo darkë të tre apo ulur thjesht rreth një tavoline duke folur për një temë të caktuar.

Ai nuk ishte pothuajse kurrë në shtëpi dhe darkave vinte gjithmonë vonë. Mbaj mend tek rrija me frymën e ngrirë, me të gjitha shqisat e mia nga dera, me orë të tëra duke ndjekur hapat e kalimtarëve të rastit, zhurmat e makinës, me shpresën se hapat e rrallë do ndaleshin në derën tonë. Isha në ankth nga ideja se diçka e keqe mund

të kishte ndodhur dhe shpeshherë e gjeja veten duke u lutur që të vinte shëndosh e mirë. Nga kjo pritje absurde pata arritur të njihja jo vetëm të ecurën e tij, por edhe zhurmën e motorit të makinës. – Erdhi – mendoja, dhe të rrahurat e zemrës më përshpejtoheshin. Dëgjoja ca hapa, ca çelësa që tingëllonin dhe një bravë që hapej, babi erdhi në shtëpi. Me t'u siguruar që dera qe hapur, vrapoja menjëherë në shtrat dhe shtrihesha e ngrirë në pozicion gjumi, nuk doja që ai ta kuptonte se isha zgjuar, nuk doja që ai ta dinte se unë po prisja. Ndonjëherë, rrallë, e ndieja që vinte tek dhoma ime, afrohej te shtrati e më puthte ballin, por këtë e bënte rrallë, shumë rrallë.

Pasi dilte nga dhoma, e gjeja veten shtrirë me sytë nga tavani duke menduar për këtë njeri të huaj, të cilin e quaja baba. Mbaj mend që pata gërmuar dikur në raftet e shtëpisë e pata gjetur një foto të vjetër të tij. Duhej të ishte diku 17 vjeç atëherë, një çun shumë i gjatë, muskuloz, me flokë të zinj, në breg të detit me shokun e tij. Po qeshnin me të madhe të dy. Krejt pa pritur u përballa me një imazh tjetër të tij, një djalë vërtet i pashëm, por mbi të gjitha më habiti e trishtoi njëkohësisht buzëqeshja e tij. Çfarë t'i ketë ndodhur vërtet këto vite, aq sa për aq kohë sa kam jetuar nuk e kam parë asnjëherë aq të lumtur. Çfarë ndodhi në jetën e tij që ta ketë shndërruar në këtë njeri mbipeshë e të trishtuar. A isha

unë ajo që kisha frenuar gjithë lumturinë prej tij, aq sa ai të kthehej në këtë qenie të ftohtë e ndonjëherë edhe agresive? Shpeshherë më ngjante me një tenxhere me presion e cila nga momenti në moment, me stimulin më të vogël, do shpërthente.

Ndihesha e turpëruar se kudo në shkollë e dinin se jam e bija e tij dhe herë pas here më toleronin ndonjë vonesë apo ndonjë notë më shumë, por unë nuk i meritoja, unë nuk mendoja se as ai i meritonte. Me mijëra herë e kisha dëgjuar të tregonte historinë e lavdishme të protestave për rrëzimin e pushtetit në fuqi, se si kishte qenë në rresht të parë, se si ishte ndier kur busti i diktatorit ishte përplasur në tokë, se si brohoriste turma e ndërsa fliste, dalloja sytë e tij të shkëlqenin nga një pasion i fshehur, një adrenalinë e çuditshme si një burim jete për një moment të vdekur tashmë. Ishte vetëm ai moment kur babai im jetonte dhe ishte i gjallë.

Sa për mua, sa herë që e dëgjoja si histori, mendoja me vete: "O Zot, mos përsëri...". Shpesh shtonte fragmente apo përsëriste të njëjtat fraza, e njëjta histori, edhe pse thellë-thellë e ndieja që nuk isha asgjë më shumë veçse xheloze që as unë e asgjë tjetër s'e bënte të ndihej kaq të lumtur.

Nëna ime, nga ana tjetër, një femër tepër e kuruar për moshën e saj dhe në përpjekje të dëshpëruar për vëmendjen

e tim eti, bëhej, si pa e kuptuar, një pre e preferuar e salloneve më luksoze të bukurisë apo dyqaneve më të shtrenjta të rrobave. Do linte shuma marramendëse lekësh për këtë produkt të ri apo atë trajtim kompleks që rastësisht na vinte gjithmonë si risi e shkencës apo moda e fundit e pasarelave të Milanos. Nuk mund ta mohoj se ishte një grua e bukur, pasi tek ecja me të, vëreja që vëmendja e kalimtarëve ishte e tëra tek ajo. Koka që ktheheshin dhe pëshpërima që dëgjoheshin pas shpine: "gruaja e kryetarit". Ajo ecte plot krenari, me një qëndrim të impostuar drejt, tek më kapte përdore me delikatesë. Sa herë që dilnim, më shihte me dhimbje zgjedhjen rastësore të rrobave dhe me shumë kujdes mundohej të më tregonte se e veshur kështu apo ashtu thjesht po lija nam.

– Xhinse dhe bluzë pambuku?! A nuk mendon se duhet të vishesh një çikë më femër?

A thua se një fustan me rrip të ngushtë në mes do të më certifikonte si femër. As që më plaste fare. Kurrë nuk i thashë atë që mendoja, që për mua ajo nuk ishte asgjë më shumë se një kukull qesharake.

Shpesh e ndieja tek vihej në siklet kur më prezantonte me mikeshat e saja, një tufë llafazanesh koti. Ndonjëra i lejonte vetes edhe ndonjë koment idiot të tipit; – Po kjo nga ka ngjarë, – ndërsa ime më qeshte me to.

Në realitet nuk më plaste për asgjë, nuk kisha një marrëdhënie të mirë me pasqyrën dhe nuk kaloja kohë e fiksuar pas imazhit tim. Ajo bluzë e thjeshtë pambuku dhe ato xhinse të vjetra ishin mburoja ime në këtë botë të çuditshme. Bota ime e vërtetë fshihej në katër muret e asaj dhome, jashtë saj unë isha veçse askushi. Isha një njeri i katapultuar në një familje të çuditshme, me një lavdi të ndryshkur dhe shpesh e pyesja veten pse kisha ardhur në këtë botë, çfarë kuptimi kishte prania ime në këtë familje.

Mbaj mend kur isha shumë e vogël, ndoshta pesë vjeç a diçka më shumë, të ishim shoqe të mira unë dhe mami. Ajo më ulte në prehrin e saj dhe më lexonte libra të ndryshëm e unë mpihesha e tëra, e zhytur në rrjedhën e ngjarjes. Zëri ishte i butë, fjalët të ëmbla dhe tek nuhasja gushën e saj, ndihesha njeriu më i lumtur në botë. Mund të zhytesha e tëra te shpirti i saj dhe asgjë nuk më trembte, as shiu e vetëtimat e as kjo botë e çuditshme. Çfarë ndodhi më pas që na ktheu në dy të huaja, aq sa shpesh pyesja veten a thua me të vërtetë kisha qëndruar nëntë muaj brenda saj, a thua vërtet zemra ime me të sajën të kenë rrahur nëntë muaj paralel njëra me tjetrën. Pyesja veten si ka mundësi që nuk arrij dot ta imagjinoj apo ndiej lumturinë që mund apo jo të ketë ndier ajo kur më pati kapur në krahë për herë të parë. Sikur të isha edhe një herë aty.

Tek kthehesha pas me mendime nga shtëpia ime në Tiranë, asgjë më shumë veçse një format më i madh i atyre katër mureve të dikurshme të shtëpisë së prindërve të mi, më vjen papritur një mesazh prej saj.

– A do vish të paktën për Vit të Ri?

E çuditshme, mendova, sa shumë kohë ishte bërë pa u takuar. Tek thellohesha me vete nëse duhej apo jo të shkoja kësaj radhe, e gjeta veten përsëri të humbur pas dritares, me vështrimin e tretur në hiç.

M'u kujtua krejt papritur shoqja ime e ngushtë, shoqja e vetme që kam pasur ndonjëherë në jetë. Herën e parë që më ftoi për drekë, mbaj mend që u mpiva e tëra nga harmonia e çuditshme në atë shtëpi. Një familje e mrekullueshme e ulur në tavolinë, babai në qendër të saj, vëllai i vogël, e ëma që ishte njeriu me buzëqeshjen më të bukur në botë shpërndante ushqimin nëpër pjata, dhe ajo, njeriu më perfekt që mund të më kenë parë sytë ndonjëherë, Mia.

I ati më tha se ia pati vënë Mia pasi ishin të fiksuar pas Mia Martinit. Në fshehtësi dëgjonin Sanremon dhe kur Mia lindi, e konsideruan jo vetëm si një mishërim të idhullit të tyre, por edhe si një gjest përparimtar në vendosjen e emrave për të përqafuar rrymat e ndryshimeve, të cilat po vinin dukshëm në Shqipëri. I ati i Mias, një burrë i bukur me sy blu, më pati treguar një herë se si ishte njohur me të ëmën

e saj, ai një rebel i atyre viteve me flokë të gjatë e pantallona "cowboy", u humb fare pas Evës, një vajzë e turpshme dhe nxënëse shembullore. Ishte dashuri me shikim të parë.

– E kuptova direkt që edhe ti më doje – i thoshte ai, teksa ajo ishte ulur në prehrin e tij me krahët rreth qafës së tij.

– Joo, – thoshte teta Eva, e zënë në faj, – s'e kisha mendjen në ashtu punësh unë, vetëm shkollë-shtëpi isha, ti insistove dhe meqë m'u qepe pas me muaj të tërë vendosa të të flas.

Ai e puthi në buzë në sy të fëmijëve të tyre, si për t'ia kundërshtuar atë që ajo sapo tha, ndërsa unë, që isha 13 vjeç atëherë, u skuqa e tëra.

Të vërtetën e mora vesh më vonë në një nga bisedat e mamit me shoqet e saj. Ai e kishte rrëmbyer atë, sepse familja e saj nuk ishte pro këtij bashkimi, pasi me sa dukej ky çun ishte tepër i hedhur për familjen e tyre. Në fakt, as sot e kësaj dite ajo nuk fliste me prindërit. Krejt thjesht, dje ishe vajza ime, sot meqë u dashurove me atë që unë nuk dua, nuk je më. Çfarë presioni i tmerrshëm, mendoja me vete. Të detyrohesh të zgjedhësh mes dy dashurive kaq të forta, po përse? Kaq keq duhet të ketë qenë në atë periudhë të ishe ndryshe nga të tjerët.

Shpesh e pata dëgjuar të na tregonte për pasionin e tij për muzikën, rock-u ishte e preferuara e tij. Ai më shpjegonte

tekstet, të cilat i dinte të gjitha përmendsh, dhe më bëri të njihesha me filozofinë e bukur të asaj rryme. Kishte liri në tekstet e tyre, një formë e çuditshme e përqafimit të jetës me një forcë që buron nga shpirti. O Zot, sa jetë shikoja në sytë e tij, tek përpiqej të më shpjegonte kuptimin. Shpeshherë ulej tek cepi i dhomës dhe merrte kitarën, teksa këndonin të gjithë së bashku këngët e tyre. Sa e gjallë që ndihesha në praninë e tyre!

Mia kishte një dhomë më vete, të cilën e konsideronim si zyrën tonë. Kishim një tavolinë në mes dhe dy karrige përballë njëra-tjetrës. Tavolina ishte plot me lapsa me ngjyra, bojëra uji, penela e fletë vizatimi të formateve të ndryshme. U fiksova që herën e parë që i pashë, aq sa mbaj mend të kisha shkuar me ide të qartë në shtëpi atë ditë se më duhej një furnizim i mirëfilltë materialesh të ndryshme për pikturë. Babai im ishte dukshëm i kënaqur nga fakti se më në fund po shprehja interes për diçka në jetë, ndryshe krejt nga rasti kur mori vesh se me vajzat e lagjes ikja fshehurazi çdo të diel në një të ashtuquajtur "Kishë për Dëshmitarët e Jehovait". Mbaj mend që më tërhoqi në dhomë, më vuri dorën në shpatull dhe më pa në sy duke më thënë:

– Mos u bëj pre e propagandës antishqiptare. Ato janë këtu thjesht me një qëllim, me një agjendë. Nuk u plas për ne. Mos kujto se do njohësh Zotin nëpërmjet tyre.

Nuk u binda direkt nga fjalët e tij dhe kryeneçe shkova përsëri, derisa një ditë e kuptova që nuk kisha as interesin më të vogël të merresha me to.

Piktura, nga ana tjetër, ishte diçka në të cilën doja të provoja veten. Nuk e di a ishte një përpjekje për të imituar Mian apo thjesht për t'i provuar vetes apo asaj se jam e zonja të paktën në diçka. Nuk di sa lekë të ketë harxhuar babai atë ditë, por mbaj mend që nuk lamë gjë pa marrë nga dyqani. Mezi prisja të takoja Mian të nesërmen dhe t'i tregoja çfarë kisha blerë dhe sa gati isha për të filluar pikturën me të. Ajo kishte një mënyrë të veçantë të frymëzuari. Ishte ajo që tregonte temën e ditës dhe paralel njëra me tjetrën fillonim punën për realizimin e saj. Vendosnim minutazhin dhe në fund shkonim tek juria për verdiktin final. Juria, që konsistonte në të atin e Mias dhe vëllain e vogël, do të gjykonte dy variantet e vizatimeve pasi më parë ishte njohur me temën e ditës. Gjithmonë punimi i saj më dukej më i miri, por nuk dekurajohesha pasi e dija që herën tjetër do e realizoja më mirë. Të atin e Mias e vëreja që mundohej herë pas here të më jepte zemër e të më vlerësonte mua më shumë, edhe pse ishte më se e qartë që ajo pikturonte më mirë, ndërsa i vëllai, mistreci i vogël, nuk gabonte asnjëherë në gjykim. Vëreja që ajo më nxiste të jepja maksimumin tim. Ajo ishte një ndër ata njerëz që qëndronin shumë lart nga

shumica, por nuk tentonte të mburrej me këtë, përkundrazi e ndieja në shikimin e saj sikur thoshte:“Është një botë e mrekullueshme këtu lart, kacavirru e ngjitu, ma jep dorën.”

Gjithçka që doja në jetë ishte aprovimi i saj, ta bindja se nuk isha një njeri i pavlerë, siç ndihesha thellë-thellë me vete. Gjëja më e bukur ishin bojërat e vajit. Ngjyrat e thella dhe të forta ishin të preferuarat e mia, ndërsa ajo notonte butë në spektrin pastel.

Sa shumë më kishte marrë malli dhe, ndërsa mendoja për të, krejt pa pritur, sikur një rreze e butë drite nisi të depërtonte në kujtimet e mia të errëta. Rrugët e atij qyteti, ajri i freskët dhe fytyrat e njohura, edhe pse të ngrysura, m’u dukën për një çast më të afërta e më miqësore.

Për një moment të vetëm harrova grinë që e kishte mbuluar gjithçka dhe gjithë zymtësinë që më kishte shoqëruar ndër vite. Harrova shiun e furishëm dhe rrugët e boshatisura në zheg, harrova sa herë kisha imagjinuar t’ia vija flakën përgjatë kufijve e të zhdukesha pa kthyer kokën pas, e tmerruar edhe unë vetë nga ideja se si toka ku ke hedhur hapat e parë mund të bëhej kaq e urryeshme.

Harrova si isha ndier për vite të tëra: e burgosur dhe e pavlerë. Harrova gjithçka… dhe, për një çast, mendova të rikthehem. Të rikthehem për pak, në kërkim të një shoqeje të humbur diku në vitet e harresës. Dhe një ndjesi e butë melankolie më pushtoi e tëra.

Ajo nuk ishte më aty, ajo ishte e ikur e harruar me kohë, por përsëri e ndjeva se një "unë" i ri duhej të kthehej në një qytet të vjetër, në kërkim të diçkaje të humbur, ndoshta të vetë shpirtit tim.

Diku në mes të Shkodrës, 1934

Herën e parë në jetë që Aishja e dëgjoi fjalën "jetime", ishte kur akoma s'kish mbushur 5 vjeç. Në një ditë të ftohtë janari, kur ajo dergjej në ethe e temperaturë, ndërsa Hatixhja qëndronte te koka e saj bashkë me mjeken, e cila po përpiqej të bënte ç'të mundte në mënyrë që e vogla të bëhej më mirë, psherëtiu: "Gjynah e shkreta dhe jetime". Aishja nuk e dinte kuptimin e vërtetë të fjalës dhe një ditë, ashtu si nga hiçi, pyeti të atin:

– Babë, ç'do të thotë jetime?

Ajo e kuptoi nga mënyra se si fytyra e të atit ndryshoi shprehje, diçka mes irritimit dhe habisë, ndoshta nuk ishte një pyetje që duhej bërë. Me sytë kuriozë të një fëmije, ajo shikonte të atin në pritje të një përgjigjeje, por ai i buzëqeshi, e përqafoi fort dhe nuk foli. Nuk ishte e nevojshme që i ati t'i shpjegonte kuptimin e asaj çfarë ajo kishte ndier gjithmonë. Nuk ishte e nevojshme t'i vihej një emër atij boshllëku që ekzistonte që kur mbante mend, ndjenjës që e shoqëronte që në momentin kur hapte sytë e derisa flinte, pyetjeve që i

vinin në mendje e kërkonin dëshpërimisht një përgjigje. Si ishte e ëma si pamje? Gjyshja i pat thënë dikur që Aishja i ngjante shumë asaj: kishte të njëjtën fytyrë rrumbullake, buzë të plota e vetulla të zeza, sytë të vegjël e plot dritë. Sa herë dilte para pasqyrës përpiqej të përfytyronte veten, por pak më të rritur.

Shpesh pyeste veten se çfarë arome do të kishte nëna e saj, si do të ishte të zhyste kokën te gjoksi i saj, e mbështetur tek shpatulla me fytyrë nga qafa e saj, ashtu si bënte Enveri i vogël te Hatixhja para se të përgjumej plotësisht. Para se të flinte, ajo mblidhte krahët afër gjoksit dhe i shtrëngonte fort, sikur donte të mbante diçka të shenjtë që të mos i largohej e të mos zhdukej përgjithmonë. Aishja e donte shumë Hatixhen dhe kishte për të ndjesinë që çdo fëmijë mund të ketë për nënën e tij, por kur Enveri erdhi në jetë dhe Aishja ishte shtatë vjeçe në atë kohë, e kuptoi që ajo nuk ishte e ëma. Dukej në mënyrën si shikonte Enverin, si i fliste, si sytë e saj shkëlqenin kur e shikonin, si e ushqente, si dridhej kur ai kollitej, si e mbulonte para se të flinte, e puthte në ballë dhe i përkëdhelte kokën. Nuk ishte njësoj kur shikonte Aishen. Sytë e saj nuk kishin po atë shkëlqim, ajo nuk i puthte ballin para se të flinte, nuk dridhej kur ajo kollitej. Një ditë, ndërsa qëndronte me gjyshen duke u ngrohur te zjarri, e përqendruar në ndriçimin që lëshonin flakët, pyeti papritur:

– A ishte e bukur?

Gjyshja, e trembur nga kjo pyetje e vogëlushes, i tha:

– Kush moj zemër?

– Mami im.

Ato kurrë nuk kishin përmendur Perihanën në shtëpi. Hamzai nuk ndihej mirë ta përmendte nusen e re që humbi gjatë lindjes së vajzës së parë. Nuk ishte mirë për të voglën, po as për Hatixhen që përpiqej me gjithë shpirt të ishte një nënë për të, prandaj për shumë kohë emri i saj nuk qe përmendur në shtëpi. Por ishte e pamundur të mendohej që nuk do të vinte një ditë që diçka duhej shpjeguar, se Aishja e vogël do të vinte gishtin në plagën që u dhimbte të gjithëve në atë shtëpi. Gjyshja iu afrua, i shtrëngoi duart dhe duke e parë në sy i tha:

– Mamaja jote ishte e bukur si perri, ndaj e kishin quajtur Perihana, por Zoti deshi ta merrte përsëri pranë vetes. Por ti mos u mërzit, shpirt i vogël, – shtoi, ndërsa merrte dorën e vogël të Aishes dhe e vendoste afër zemrës, – ajo është përsëri këtu me ty. Aishja buzëqeshi e lehtësuar.

Çdo ditë pasi vinte nga shkolla, ngjitej lart te dhoma e gjumit, mbyllte derën, qëndronte te cepi i dhomës dhe me dorën te zemra i tregonte të ëmës çdo gjë që kishte mësuar në shkollë.

Ditën e parë të shkollës ishte gjyshja që e përcolli, pasi

Hatixhja duhej të kujdesej për Enverin dhe, ndërkohë që e ndihmonte të vishej, i thoshte:

– Që sot do fillosh të mësosh lexim dhe shkrim. Aishja u magjeps nga këto fjalë, sa bukur do të ishte të dinte të shkruante dhe lexonte!

Në hyrje të shkollës ishin plot prindër që shoqëronin fëmijët e tyre për të mësuar të shkruanin e të lexonin. Gjyshja e përcolli deri tek hyrja e klasës, ku e priste mësuesja, një zonjë e bukur dhe e buzëqeshur, e cila i tregoi ku duhej të ulej. Në klasë kishte dy rreshta me banka, një për vajzat e një për djemtë. Ajo ishte pranë një vajze të vogël me flokë gështenjë, e cila rrinte e ngrirë në cepin e bankës, e frikësuar dhe gati për t'ia plasur vajit. Aishja e shikonte me habi dhe i buzëqeshi. Pasi ktheu kokën djathtas, te rreshti i djemve, syri i kapi një djalë që po qante me dënesë dhe nuk po e kuptonte se përse ishin kaq të trishtuar gjithë këta fëmijë; a nuk e dinin ata që do mësonin të shkruanin dhe lexonin? Në bankën e fundit, te rreshti i djemve, ishte një nxënës i vetëm që çuditërisht tërhoqi vëmendjen e saj; diku e kishte parë. Më pas u kujtua se ai nuk ishte as më shumë e as më pak se i biri i kasapit të qytetit, ku babai blinte mishin. Një ditë Aishja kishte qenë me të atin, ndërkohë që ai po merrte porosinë e radhës, dhe aty pas banakut, bashkë me kasapin, asaj i pat tërhequr vëmendjen edhe një djalë i vogël i moshës së saj. Ai

ishte kaq i shëmtuar, saqë ishte e pamundur të mos e fiksoje, por nuk bëhej fjalë vetëm për një fëmijë të shëmtuar; ajo që të trembte më tepër ishte shikimi i tij therës dhe vetullat e ngrysura. Kur e kuptoi që ai po e shikonte, Aishja uli sytë në tokë e trembur dhe u ngjesh pas të atit.

Dhe ja ku ishte, në fund të bankave, i vetëm.

Mësimi zgjati vetëm dy orë dhe të gjithë u larguan në shtëpitë e tyre.

Gjatë rrugës për në shtëpi mezi priste të mbyllej në dhomën e saj dhe t'i tregonte nënës së vet se çfarë kishte mësuar sot dhe sa e lumtur ishte. Tek ecte në rrugicë me shikimin përtokë dhe buzëqeshje në buzë, dëgjoi dikë që e thërriste nga pas:

– Hej ti, e bija e Hamzait.

Ajo shtangu në vend dhe vendosi të ecte pa kthyer kokën pas.

– Me ty e kam, përse nuk ndalon?

Mendimi i parë ishte të merrte një gur dhe t'i gjuante. Ktheu kokën dhe ja ku ishte ai, i buzëqeshur. Afër tij ishte edhe një shok tjetër, i cili diçka i thoshte në vesh dhe, ndërkohë që shtynin njëri-tjetrin duke qeshur, ia bëri përsëri:

– Përse nuk më përshëndete? – tha ai, ndërkohë që kishte marrë një pamje serioze.

– Nuk të njoh, –i tha Aishja e trembur.

– Si nuk më njeh? Të zura që po më shikoje në klasë. Mirë, mirë eja të përshëndetemi tani që u njohëm.

– Si? – pyeti Aishja e trembur.

– Po ja të shtrëngojmë duart, – tha ai, ndërkohë që shoku i tij vazhdonte e zgërdhihej.

Aishja e trembur iu afrua dhe, në ndrojtje, zgjati dorën. Ai, me njërën dorë, shtrëngon dorën e saj, ndërsa me tjetrën, të cilën e ka grusht, ia vë në qafë, ku i lëshon diçka të çuditshme që i hyn poshtë bluzës dhe që vërtitet nëpër shpinë. Ndërkohë që Aishja përplaset në tokë, heq bluzën, nga ku çliron hardhucën e shkretë që i biri i kasapit kishte kapur dhe ia kishte lëshuar në shpinë, poshtë bluzës. Ata të dy shkrihen së qeshuri dhe ia mbathin vrapit. Ajo mbeti e ulur në tokë, veshi bluzën dhe filloi të qante, të qante nga inati se si u tregua kaq e pazgjuar ta kuptonte hilen dhe se si e la veten të bëhej gallata e tyre. U ngrit në këmbë, fshiu pluhurin e tokës, fshiu lotët dhe vazhdoi rrugën për në shtëpi. Kur Hatixhja e pa gjithë pluhur, filloi të bërtiste pa kuptuar se çfarë kishte ndodhur, ndërsa Aishja vrapoi për t'u ndërruar. A duhej t'i thoshte babës për këtë që kishte ndodhur? Me siguri ai nuk do e linte të shkonte më në shkollë, ose, më keq, do i thoshte:

– Përse ishe vetëm në rrugë dhe pse pikërisht u kap me ty?

Po sikur ai ta priste çdo ditë pas shkolle, çfarë do të bënte ajo? Do t'i gjuante me gurë? Po, po do kapte një gur në tokë dhe do ta godiste. Po sikur ta lëndonte ndërkohë që e gjuante?

Me këto mendime në kokë, Aishja qëndroi gjithë ditën dhe deri vonë nuk e zuri gjumi. Vendosi që do të shkonte të nesërmen në shkollë.

Erdhi mëngjesi dhe filloi të bëhej gati për shkollë. Lau duart, fytyrën dhe dhëmbët, fshiu fytyrën dhe u vesh, dhe ndërkohë doli nga shtëpia e fortë dhe e bindur se nuk do të linte të birin e kasapit të tallej me të. Ora e mësimit shkoi shumë mirë. Sot kishin filluar mësimin e germave. Germa e parë që do mësonin ishte germa "A". Mësuesja vizatoi si fillim në dërrasën e zezë tre vija paralele, dy me distancë të gjerë dhe dy të tjera pak më të ngushta, pak a shumë për të treguar si ishte imazhi në fletoren që Aishja kishte hapur në faqen e parë. Baba, i cili i pat blerë fletoret bojën dhe kalemin një javë përpara se Aishja të fillonte shkollën, qe ulur me të në tavolinën e bukës dhe i pat shkruar emrin e saj në fletore. Aishja, për herë të parë, po shikonte se si emri i saj dukej në letër. Ajo u magjeps nga rrumbullakësia e germave dhe përsosmëria me të cilën baba shkruante, se si mbante kalemin në dorë, se si gjurma që linte boja blu, e njomë në fillim, thahej, dhe ndoqi me sy çdo germë, çdo

lëvizje, me shpresën se shumë shpejt do të shkruante vetë emrin e saj. Dhe sot, në ditën e dytë të shkollës, ajo do të mësonte pikërisht germën e parë të emrit të saj. Mësuesja, pasi u shpjegoi disa emra që fillonin pikërisht me këtë germë, filloi me shkumës të bardhë në dërrasën e zezë të shkruante "A" e madhe e shtypit dhe "a" e vogël e shtypit. Aishja, e përqendruar sa te tabela e sa te fletorja, përpiqej të mbante kalemin sa më drejt që ishte e mundur dhe në fund ia arriti.

Pasi shkroi germën e parë, siç e kishin për detyrë, klasa duhej të vazhdonte deri në fund të rreshtit dhe për detyrë shtëpie duhej po këtë gjë ta bënte në dy faqe: një faqe me germë të madhe dhe një faqe me germë të vogël.

Aishja ishte vërtet e lumtur në shkollë. Për herë të parë e kuptoi se nuk kishte lumturi më të madhe se kur mëson diçka të re.

Normalisht, ajo ndihmonte edhe Hatixhen në punët e shtëpisë, pasi Hatixhja ankohej shpesh se Aishja ishte vajzë dhe si e tillë duhej të punonte; jo për gjë, por në momentin që të martohej dhe të shkonte në derë të huaj, do të ishte Hatixhja që do kishte namin e keq, pasi nuk e kishte edukuar siç duhet. Kështu që shpeshherë mundohej t'i ngarkonte ndonjë detyrë të vogël. Si për shembull, një ditë i caktoi për detyrë të qëronte patatet, të cilat i duheshin

gjyshes për të gatuar gjellën. Aishja pati marrë një kokërr të madhe patate dhe me një thikë filloi ta qëronte, mirëpo në fund, kur Hatixhja mori për të larë patatën e qëruar, pa që as gjysma e saj nuk kishte mbetur, pasi bashkë me lëkurën kishte hedhur në pleh edhe një pjesë të mirë të patates.

Hatixhja filloi të ulërinte se si kishte mundur të hidhte në pleh ushqimin dhe sa gjynah i Zotit ishte, se sa shumë mundohej baba i shkretë të punonte gjithë ditën dhe me gjak të zemrës kishte blerë patatet. Aishës, me të gjitha këto që dëgjoi, nuk mund t'i vinte në mend asgjë tjetër, veçse që ajo nuk dinte të bënte asgjë.

E njëjta gjë ndodhi teksa lante gotat dhe, pa dashje, i rrëshqiti njëra nga dora. Gota ra në pllakën e gurit të lavamanit dhe u shkërmoq në një mijë copa. Po si nuk po arrinte të mësonte një punë të vetme? Po si do të rriste nesër fëmijët e vet, kur nuk lante dot një gotë?

Ajo nuk ishte për asgjë!

Në shkollë ishte e kundërta; çuditërisht ajo ishte e zonja të mësonte të shkruante. Sa bukur do të ishte kur një ditë të arrinte të shkruante të gjitha germat e alfabetit, e sikur me to të shkruante jo vetëm emrin e saj, por ndoshta një fjali të tërë.

Asgjë në botë s'e bënte Aishen më të lumtur se mësimi i diçkaje të re. Ato dy orë në ditë ishin lumturia më e madhe

në botë, pastaj ajo mezi ç'priste që në darkë, para se të flinte, të vinte dorën te zemra dhe t'i thoshte nënës së saj se sa gjëra të bukura kishte mësuar sot dhe se sa e zonja ishte ajo në shkollë.

Shkolla ishte në qendër të qytetit, një godinë e vogël dykatëshe që dikur kishte qenë shtëpi, të cilën të zotët kishin vendosur t'ua jepnin qytetarëve për të mësuar fëmijët.

Në fakt, ajo nuk kishte ndryshim nga shtëpitë e tjera përdhese që ishin rresht njëra pas tjetrës, secila me bahçen e vet të vogël.

Që të shkoje nga shtëpia e Aishes për në shkollë, duhej të merrje rrugën poshtë deri tek shtëpia e Bushatlinjve, e cila ishte shtëpia më e madhe e zonës dhe me oborrin më të madh, pastaj të ktheheshe djathtas deri tek shtëpia e fundit e rreshtit, ku do të futeshe në një zonë të ngushtë në bahçen e shtëpisë me trëndafila dhe nga aty dilje në rrugën e gjerë, ku në qendër, shtëpia e pestë radhazi, ishte shkolla e saj.

Pasi doli nga shkolla, në dalje të saj e priste ai me shokun e tij.

Aishja mendoi të mos i shikonte fare dhe të ecte drejt për në shtëpi me hap sa më të shpejtë që të mundte, por e ndiente që ata ishin vënë pas saj.

Sa më shpejt që ajo ecte, aq më shumë shpejtonin hapat ata të dy. Ishte e pashmangshme që po e ndiqnin. Në një

pikë filloi të vraponte me sa fuqi që kishte, me shpresën që t'i shmangte, dhe vendosi të futej në mes të një bahçeje, duke e ditur se duke e përshkuar atë do të dilte për shkurt tek rruga e shtëpisë së saj. Aishja vrapoi mes për mes oborrit të shtëpisë, me shpresën që të kalonte gardhin në fund të saj e të dilte nga pjesa e pasme në rrugën që të shpinte tek shtëpia. U fut mes hardhive të shtëpisë së njerëzve të huaj; vetëm një vrap përgjatë oborrit dhe ja hodhi.

Ata të dy e ndiqnin nga pas dhe vazhduan rrugën pas saj. Në një çast, këmba i rrëshqiti në një gropë me ujë të thellë e të trashë. Ajo ulëriti aq fort, sa i zoti i shtëpisë doli me shpejtësi nga dera për në oborr për të kuptuar se çfarë po ndodhte.

Në këtë çast, i biri i kasapit me shokun e tij u kthyen pas nga frika se mos hanin ndonjë dru të mirë nga i zoti i shtëpisë.

– Çfarë mund të ketë ndodhur? – pyeti shokun e vet i biri i kasapit.

– Nuk e di, por po na zunë e kemi punën keq, kështu që ikim sa më shpejt – u përgjigj shoku.

Aishja përpiqej të dilte, duke u dhënë fort këmbëve dhe duarve, ndërsa uji i qelbur e tërhiqte poshtë.

Ajo i zgjati dorën të zotit të shtëpisë, i cili erdhi menjëherë, bashkë me qenin e tij dhe me kobure në dorë. Ai

ulërinte me sa fuqi kishte dhe thoshte ca fjalë e të shara, të cilat Aishja as që arrinte t'i dëgjonte dot. Zhytej e ngrihej në ujin e qelbur, pa mundur të dilte, kur në një moment ndjeu një dorë që e tërhiqte dhe e pa veten të plasur në bar. Akoma në panik, nuk dinte për çfarë ishte më shumë e trembur: nga frika se mos qeni i të zotit të shtëpisë do ta shqyente të tërën, nga koburja e të zotit të shtëpisë apo nga fakti se nuk e dinte në çfarë uji ishte zhytur e tëra.

Ai filloi të gjëmonte sërish, se pse e tek e çfarë donte ajo në oborr të tij, se si nuk i vinte turp, pasi ishte dhe vajzë, ajo mund të kishte vdekur në atë ujë po të mos dilte në kohë ta shpëtonte.

Aishja u ndie e poshtëruar nga të sharat e të zotit të shtëpisë. Një lëmsh iu mblodh në fyt, teksa donte të qante e nuk qante dot. Një ndjesi të vjelle e mbërthente nga uji i qelbur që duhet të kishte pirë nga zhytjet e disahershme, por mbi të gjitha u ndie budallaqe.

Kaq i madh ishte gabimi i saj vetëm se ishte një vajzë? A nuk mundet çdo njeri të gabojë, të rrëshqasë në një gropë të qelbur në tentativë për t'u shpëtuar dy budallenjve? Ishte komplet faji i tij, faji i të birit të kasapit që e kishte zënë keq me të.

Ç'të keqe i kishte bërë ajo atij që të tallej me të? Aishja fshiu fytyrën me duar dhe u ngrit në këmbë, e bindur se e

dinte se çfarë duhet të bënte. Pasi i kërkoi të falur të zotit të shtëpisë, doli nga oborri drejt e në rrugën kryesore dhe eci mespërmes qytetit.

Ajo ecte në mes të rrugës, e qullur kokë e këmbë në lëngun e shpifur që qelbte, pa e vrarë mendjen për të qeshurat e njerëzve në rrugë dhe për pështpërimat që linte pas.

Dhe ja ku arriti tek dyqani i mishit në qendër të qytetit.

Aishja hapi derën dhe në dyqanin plot me njerëz ndodhej kasapi, i cili shtangu në vend kur e pa.

– Djali yt më ndoqi dhe më shtyu në një gropë me ujë të qelbur, – tha ajo plot vendosmëri. – Po të mos më kishte shpëtuar një zotëri, do të kisha vdekur në vend.

Dhe pa e kuptuar, ia plasi vajit.

– Hamiit! – ulëriti kasapi me sa kishte fuqi dhe pas perdes së dhomës nxori kokën i biri, me një pamje të një njeriu që e dinte mirë se çfarë e priste. Pa i dhënë as mundësinë më të vogël për shpjegim, Hamiti ndjeu një dorë që e tërhoqi fort nga veshi dhe një tjetër që i gjuante shuplakë në drejtimin tjetër, dhe pastaj një tjetër në anën e kundërt, sepse një e vetme nuk mjaftonte, dhe ja një shuplakë e fortë kokës që u pasua me një shkelm vitheve.

Goditjet vinin nga nuk e priste dhe hundët nisën t'i rridhnin gjak. I ati, kur e pa të birin të gjakosur, u tremb nga forca që padashur kishte arritur të ushtronte mbi djalin e tij.

I zgjati një shami dhe, me zërin e dhembshur të një babai të penduar për çfarë i kishte bërë të birit të tij, i tha:

– Ik tashi, shko në shtëpi te jot ëmë.

Aishja, që kishte ngelur e shtangur para kësaj skene, u tremb nga ajo që kishte shkaktuar.

Papritmas e ndjeu se ndoshta duhet ta kishte lënë me aq. Ç'nevojë kishte ta padiste te i ati?

Por ajo nuk e dinte se çdo shuplakë apo goditje që i ati bënte Hamitit do ta ndiente dhe ajo, a thua se ishte ajo që kishte nisur gjithë këtë luftë, a thua se ishte ajo e cila e kishte trembur, tallur e ndjekur që në fillim dhe gati-gati mbytur, qoftë edhe pa dashje.

Hakmarrja mbart gjithmonë një rrezik të fshehur: edhe kur të duket e drejtë, në fund të rëndon më shumë se faji i atij që e nisi. Sepse kufiri i "barazimit të hesapeve" është veç një vijë e brishtë mbi rërën e bregut: mjafton vala e parë për ta fshirë pa mëshirë, duke të lënë sërish në borxh, ndoshta edhe më thellë, ndoshta përjetë.

Me lotët që i rridhnin çurg dhe me ndjesinë e fajit, mori rrugën për në shtëpi.

Sapo Hatixhja e pa në atë gjendje, u turr deri në fund të oborrit, e tronditur e pa frymë, duke derdhur një lumë fjalësh: si, pse, ç'kishte ndodhur, që s'kishin kohë as të merrnin formë.

Mes gjithë asaj rrëmuje, një fjali përsëritej si jehonë paniku:

– Kuku po ta marrë vesh yt atë!

Duke e tërhequr tërbuar nga krahu, e futi në banjo, vuri ujin të ngrohej në zjarr dhe i hoqi rrobat e qelbura.

– Çfarë dreqin ndodhi? Ku je zhytur kështu?

Aishja, që dridhej në cepin e banjës, pak nga frika e pak nga të ftohtit, belbëzoi nën zë:

– Po… ja, rrëshqita në gropë rrugës për në shtëpi nga shkolla.

Hatixhja doli për të marrë kazanin e rëndë me ujë të ngrohtë, sapunin e shpalëzën, filloi t'i kruante shpinën Aishes. Ajo kruante aq fort, saqë gati i rropi lëkurën e njomë, por ndoshta duhej rrjepur lëkura që era e qelbur të largohej.

Shpëlarje me ujë përvëlimi e përsëri kruajtje me shpalëzë e sapun, përsëri ujë i ngrohtë që përvëlonte edhe më shumë në lëkurën e skuqur, dhe pas një ore e gjysmë të kësaj torture, Aishja përsëri qelbte. Po në çfarë dreq uji kishte rënë vallë që të mos i ikte era kështu?

Ndërkohë që e fshinte me peshqirin e pastër, pasi fërkoi me sa forcë kishte në flokët e lagësht, aq sa i dhimbte qafa, Hatixhja në një moment pushoi, e pa në sy dhe i tha:

– Nuk duhet ta marrë vesh baba yt, më premton? – tha ajo, teksa e fiksonte në sy në pritje për besnikërinë e Aishes.

– Po e mori vesh yt atë, nuk do të të lërë të dalësh nga shtëpia dhe Zoti e di çfarë do më thotë mua, e kupton?

– Po, – tha Aishja, edhe pse nuk e dinte se cili ishte faji i saj dhe aq më tepër faji i Hatixhes.

Hatixhja e ndihmoi të vishej me rrobat e lara dhe, pasi u shtri në shtrat, e mbuloi me jorgan dhe e puthi në ballë.

– Gjumi i ëmbël, – i tha dhe u largua.

Aishja, pas gjithë asaj dite të gjatë e të lodhshme, nuk arrinte të harronte dot figurën e ngulitur në mendje të fytyrës së Hamitit dhe gjakun që rridhte nga hundët.

– Më vjen keq! – tha ajo, teksa vinte dorën në zemër dhe fliste me të ëmën.

Hatixhja, teksa mbyllte derën e dhomës, akoma pa u larguar nga pragu i saj, dëgjoi një pëshpërimë të Aishes. Nuk ishte hera e parë që dëgjonte që ajo fliste me vete. Diçka me siguri nuk shkonte me këtë vajzë. Kaq e pamundur për të ishte të sillej si të gjithë moshatarët e saj dhe të mos i sillte probleme njerkës së saj, e cila, që kur Aishja ishte foshnjë, e pat mbajtur në gji plot dashuri.

Ishte përpjekur të bëhej nënë për të, me gjithë përkushtimin dhe butësinë që do t'i falte edhe nëna e saj, po të ishte ende gjallë. E kishte mbajtur pranë si të ishte e saja, pa kursyer as durimin, as dashurinë, edhe tani që vështirësitë

vetëm sa shtoheshin me të. Por e vërteta qëndronte e ftohtë dhe e palëkundur: ajo nuk ishte vajza e saj.

Ishte fëmija i dikujt tjetër, i një të panjohuri për të, po aq i largët sa vetë kjo vajzë që kishte përpara. Shpesh ajo mendonte fatin e saj, se si ishte martuar me një burrë të ve me një foshnjë jetime, dhe pyeste veten nëse do të kishte po të njëjtat dyshime që e gërryenin, nëse do të ishte ajo e para dhe e vetmja grua e Hamzait. Larg qoftë sikur ky fëmijë, kjo gjurmë apo hije e kësaj të vërtete të pashmangshme, të mos kishte ekzistuar kurrë.

Hatixhja ishte një grua e të tetëmbëdhjetave kur u martua me Hamzain, të atin e Aishes, pas vdekjes së gruas së tij të parë, Perihanës. Nuk ishte e lehtë për të, të pranonte të merrte për burrë një burrë të ve me një vajzë të porsalindur, të zinte një vend që kishte lënë bosh një grua tjetër, të bëhej njerkë e një foshnje katër muajshe pa u bërë një herë nënë për vete, të përkujdesej për të e të vendoste për një ndryshim kaq të madh, krejt papritur, por i ati e kishte konsideruar si një rast që nuk duhej lënë të ikte, pasi Hamzai ishte burrë punëtor që do të kujdesej për familjen e vet, kështu që Hatixhja u detyrua ta pranonte menjëherë. Hatixhja gjithmonë mbante mend thënien e nënës së saj se vajza lind në shtëpi të huaj dhe ikën në shtëpi të vet; por ku ishte vërtet shtëpia e saj?

Sa fat i keq e shoqëronte të qenit femër që në momentin e parë të ardhjes në këtë botë dhe sa i madh ishte haraçi që duhej paguar për këtë "gabim gjenetik", aq sa edhe koha vetë, çuditërisht, rridhte më shpejt për një femër. Ajo ishte vajzë e vetme mes katër vëllezërve, nga të cilët tre ishin martuar, ndërkohë që në derën e saj nuk kishte trokitur asnjë rast i denjë për martesë.

E vërteta e trishtuar dhe e hidhur e të ashtuquajturit fat të një vajze, ishte se atë e martonin tri gjëra: emri i familjes, pasuria e babait dhe bukuria e saj, por fatkeqësisht ajo nuk kishte asnjë nga këto. Prandaj, kur njëra nga kunatat e saj pranoi të bënte shkuesen me kushëririn e saj të ve, nga i ati u konsiderua si një rast i mirë.

Fakti që ai kishte një fëmijë, sado i vështirë në fillim, në themel nuk përbënte një problem për të; ajo gjithmonë i kishte dashur fëmijët dhe ëndërronte të sillte në botë sa më shpejt krijesën e saj, të cilën ta lante, ta ushqente dhe ta përkëdhelte. Në fund të fundit, a nuk ishte ky qëllimi i ekzistencës së saj, arsyeja pse Zoti e kishte sjellë në këtë tokë? Ndërkohë ishte edhe një bebe e vogël që kishte shumë nevojë për përkujdesje dhe ajo e dinte se duhej të bënte çdo gjë me zemër, në mënyrë që të ishte si nënë për të, dhe ajo vërtet besonte se mund të ishte në gjendje, pse jo, ta donte atë fëmijë.

Duke qenë se Perihana kishte vetëm katër muaj që ishte ndarë nga jeta, pasi solli në këtë botë vajzën e saj, Aishen, nuk u pa e arsyeshme të bëhej ndonjë dasmë. Nusja u përcoll drejt shtëpisë së re në heshtje, vetëm nga daja i madh, bashkë me pajën e qëndisur me duart e saj, fije pas fije, si një ëndërr e brishtë për familjen që kishte shpresuar të ndërtonte.

Te pragu i derës e priste vjehrra, e cila sipas zakonit mbante në dorë një bukë dhe një tas me mjaltë. Hatixhja leu pragun e derës me mjaltë nga tasi dhe vendosi nën sqetull bukën, dhe, kuptohet, hyri me këmbë të djathtë, duke u lutur në Zot që të sillte me vete mbarësi në këtë shtëpi. Përpara se të takonte Hamzain, Hatixhja donte të mbante në dorë një herë Aishen e vogël. Me zemrën që i rrihte fort, tek afrohej te djepi i vogël në cepin e dhomës, pa një bebe të vogël si drita që flinte e qetë. Hatixhja u përkul afër djepit dhe përkëdheli lehtë faqen topolake.

Çdo ditë Hatixhja zgjohej herët, mbushte ujin, ndizte zjarrin dhe gatuante mëngjesin për të shoqin, i cili nisej për punë shumë herët; pastaj, pa u zgjuar vjehrrit, pastronte shtëpinë dhe lante oborrin dhe, pasi kryente të gjitha këto, merrte Aishen e vogël, e cila sapo ishte zgjuar.

Hamzai ishte shumë i sjellshëm me gruan e tij të re, edhe pse ata të dy rrallë kishin një komunikim që nuk

konsistonte në fjali bazike për gjellën që ishte gatuar, nëse kishte kripë mjaftueshëm apo jo, nëse donte fasule për ditën e nesërme apo do të gatuanin diçka tjetër. Në fund të darkës, pavarësisht nëse ishte apo jo i kënaqur me cilësinë e ushqimit, gjithmonë do ta përgëzonte për gatimin. Kjo ishte rutina që shoqëronte ditët e tyre, një nga një.

Fëmija i parë erdhi vonë në jetën e tyre, aq vonë sa Hatixhja tashmë i kishte humbur shpresat se do të gëzonte ndonjëherë në këtë jetë të qenit nënë. Por, me sa duket, kështu qenka me mrekullitë: ato ndodhin pa pritur e pa lajmëruar, një çast të vetëm përpara se shpirti të dorëzohet plotësisht.

Dhe ja ku erdhi: një mrekulli e mishëruar në një djalë të shëndetshëm, pesë kilogramësh.

Kur Hamzai e mori për herë të parë në krahë, sytë iu mbushën me lot; dhe atë çast, për herë të parë në jetën e tij, zemra i njohu një ndjenjë të re, dashurinë për gruan e vet.

Pas një viti e gjysmë, ata do të bëheshin prindër të një tjetër djali dhe, pas dy vitesh, erdhi Enveri i vogël. Kaq shumë lumturi, kaq shumë fat i papritur, kaq shumë bekim nga Zoti, që e mbushi Hatixhen shpirtërisht aq sa u ndie e plotë dhe e lumtur në këtë botë. Por lumturia më e madhe, ashtu si të brengos shpirtin kur e kërkon dëshpërimisht, ashtu të kthen në njeriun më egoist në momentin kur e arrin.

Tashmë, sado që të përpiqej të mos ia pranonte vetes, ishte më se e qartë për të se qëllimi, lumturia dhe çdo gjë e shenjtë në këtë botë ishin tre djemtë e saj dhe askush tjetër. Aishja e shihte këtë në sytë e Hatixhes, të cilët nuk e fshihnin dot indiferencën dhe moskokëçarjen për vajzën e burrit të saj. Por, pavarësisht kësaj, ajo ishte thellësisht e shqetësuar për edukatën që do të merrte kjo vajzë, pasi duhej të rritej për së mbari e të mos e turpëronte. Kjo e shqetësonte pa masë, sidomos tani që ishte hera e tretë që e dëgjonte duke folur me vete para gjumit, pa llogaritur katastrofën e sotme dhe gjendjen në të cilën i erdhi në shtëpi.

– Çfarë dreqin mund t'i kishte ndodhur vallë? Po sikur ta kishte marrë vesh Hamzai?

Nuk vonoi më shumë se zakonisht dhe Hamzai u kthye atë natë në shtëpi, dhe ishte më se e dukshme nga çehrja e tij se diçka e shqetësonte.

Sapo hyri në shtëpi, menjëherë pyeti Hatixhen se ku ishte Aishja dhe kur kishte ardhur në shtëpi.

Hatixhja, nga frika, u detyrua t'i tregonte gjithçka. Siç ndodh rëndom në qytetet e vogla, çdo ndodhi do tri orë që të përhapet në të gjithë qytetin dhe, brenda pak kohe, kalon në çdo gojë duke marrë forma nga më qesharaket. Hamzai kishte dëgjuar atë ditë se e bija e tij, pasi kishte lënë orën e mësimit, kishte hyrë për të vjedhur kumbulla te

komshiu dhe, në ikje e sipër, kishte rënë në gropën septike në shtëpinë e tyre, dhe se i zoti i shtëpisë e kishte shpëtuar duke e nxjerrë për veshësh jashtë.

– Turp! – tha Hamzai, duke i rënë me grusht tavolinës. – Ajo nuk ka për të dalë më nga shtëpia, madje ma zgjo nga gjumi tani!

Hatixhja kurrë nuk e kishte parë Hamzain në atë gjendje. E trembur, ajo vrapoi të zgjonte Aishen, e cila ishte në gjumë të thellë dhe ende nuk e kuptonte se çfarë po ndodhte.

– Ti më ke turpëruar mua, babanë tënd! – tha ai, duke e parë egër në sy. – E ke të ndaluar të dalësh nga shtëpia! Nuk do të shkosh në shkollë dhe, po të të shoh më larg se dera e oborrit… për atë Zot… – tha ai dhe heshti, pa dashur të fliste më shumë.

Aishja u ndez në fytyrë, pa dashur t'i besonte asaj që po dëgjonte dhe, duke mos e kuptuar nëse ishte në ëndërr apo zgjuar, mbeti e shtangur në vend. Ishte Hatixhja ajo që e mori për krahu dhe e përcolli edhe një herë në dhomën e gjumit për të fjetur, pa qenë e zonja të thoshte as edhe një fjalë të vetme.

Në momentin kur ishte vetëm në dhomën e saj, Aishja e kuptoi se ç'kishte ndodhur në të vërtetë: babai i saj ishte me gjithë mend i mërzitur me të, aq shumë sa ajo nuk e dinte

nëse do të vinte ndonjëherë një ditë që i ati ta shihte në sy siç e kishte parë më parë. Ata sy kaq të dashur e të dhimbsur për të, ata sy që ishin fortesa dhe mburoja e saj e vetme në këtë botë, ishin zhdukur pas perdes së urrejtjes apo, qoftë edhe, indiferencës që tashmë ishte më se e lexueshme. Ai nuk e donte më. Pse duhet ta donte, sidomos tani që vendin në zemrën e tij e kishin zënë tre bij, tre djem?

Aishja mbante mend mirë lumturinë në sytë e të atit kur mori vesh se ishte shtuar me djalë. A thua vallë ishte po ajo lumturi kur kishte ardhur ajo në jetë? Ndoshta do të kishte qenë më mirë sikur edhe ajo të kishte ikur me të ëmën në të njëjtën ditë; ndoshta në këtë mënyrë nuk do të ishte ndier kaq e tepërt dhe pa një vend në këtë botë, si një krijesë e varfër mes dy botëve të ndryshme: asaj të vdekur të së ëmës dhe asaj të gjallë të të atit; njëkohësisht në dy anë dhe, në realitet, askund, përveçse pasqyrë e të panevojshmes, e të urryeshmes dhe e mëshirës.

Aishja bëri një pakt me veten atë ditë: nuk do të krijonte asnjë problem në këtë shtëpi, as edhe një. Nuk do të kalonte pragun e derës, ashtu siç i patën urdhëruar, nuk do të fliste asnjë fjalë të vetme, nuk do të shprehte as edhe një mendim të vetëm; pothuajse nuk do të ekzistonte.

Tiranë, 1969

Ishte pothuajse ora tre e mëngjesit kur ata të dy dolën nga shtëpia. Errësirë e thellë dhe një qetësi mbytëse mbizotëronte kudo: ajo lloj qetësie që mbulon çdo shikim, çdo fjalë, çdo gjykim. Ai ecte përpara dhe ajo pas, pa shkëmbyer as edhe një fjalë të vetme. Treni nisej në orën tre e gjysmë.

– Hera e fundit – ia përsëriste vetes Anita. Jo si një mendim i thjeshtë, por si një përpjekje e dëshpëruar për ta bindur veten se pas kësaj dite nuk do të kishte më kthim. Se ai takim do të ishte i fundit. Se gjithçka do të zhdukej, sikur të mos kishte ekzistuar kurrë as ajo, as gabimi i saj.

Dy herët e para mbante mend se kishte qarë për një javë rresht, e ndryrë në dhomën e saj, pa dashur as të hante, as të pinte, e mbytur nga ndjenja e boshllëkut. Ishte sikur një dorë e fuqishme të ishte ngulur në shpirt dhe, me një goditje të vetme, t'i hiqte zemrën nga vendi.

Por asgjë që ndodhte brenda saj nuk krahasohej fare me atë që e rrethonte jashtë, me ndjenjën e turpit dhe

poshtërimit që i kishte shkaktuar familjes saj. Askush përjashta asaj shtëpie nuk duhej ta dinte të vërtetën; asnjë i afërm, asnjë shoqe nuk duhej të kishte as edhe më të voglin dyshim për gjëmën që kishte shkaktuar ajo me pakujdesinë dhe me injorancën e saj.

– I ke vënë vërtet qëllim vetes të më vrasësh mua dhe babanë tënd. Nëse vërtet ke vendosur këtë, po të them se të vras unë, me duart e mia. Unë të bëra dhe unë të vras. – i pat thënë një herë e ëma, teksa e shikonte ftohtë në sy dhe me bindje në fjalët që sapo nxori, ndërsa e detyronte të vishej dhe të shkonte në shkollë. E ëma ishte një grua e ftohtë dhe e prerë. Ajo fliste pak, por me një shikim dhe dy fjalë ishte në gjendje të rrëzonte në gjunjë edhe shpirtin më të fortë. Brenda shtëpisë ishte e pamëshirshme; jashtë saj, e rrezikshme deri në mashtrim dhe shpifje, kur vinte puna për të mbrojtur elementin më të tmerrshëm për mbijetesën e një vajze: opinionin publik.

Një ditë, ndërsa Sania, një nga komshiet e saj, po tentonte pa pikë takti t'i tregonte atë që pak a shumë përflitej nëpër rrugë, se gjoja vajza e saj, Anita, ishte parë një ditë në hyrjen e një pallati duke folur me një djalë i cili, pavarësisht se në dukje ishte një shok klase, nga mënyra se si po flisnin nuk mund të ishte gjë tjetër veçse një muhabet i pamoralshëm, ajo, me një siguri të frikshme dhe duke e parë thellë në sy, i tha:

– Nuk ka as edhe një mundësi, pasi vajzën time e dërgoj unë në shkollë në mëngjes dhe, fiks kur mbaron orari i shkollës, jam unë ajo që e marr për në shtëpi. Dhe sapo vjen në shtëpi, ajo menjëherë ulet dhe bën mësimet; madje gjithmonë më ndihmon me punët e shtëpisë. Në takimin e fundit me prindër, emri i vajzës sime u përmend si nxënësja më e mirë e shkollës. Dhe, meqë ra fjala te shkolla, si po shkon vajza jote me kiminë? Pasi të pashë shumë të shqetësuar atë ditë; një katër në regjistër nuk thyhet kollaj. Sa gjynah dhe turp do të ishte që në fund të mbetej në klasë, pas gjithë atyre sakrificave që ju po bëni për të! – tha ajo me një imazh të rremë keqardhjeje.

Fytyra e Sanies ndryshoi papritmas, nga orientimi i imponuar që iu dha bisedës dhe shqetësimeve të saj, por një gjë ishte e sigurt: në prani të saj nuk guxonte më të bënte komente të tilla.

Pavarësisht qëndrimit ndaj Sanies atë ditë, me t'u kthyer në shtëpi, i hodhi një vështrim urdhërues vajzës, duke drejtuar kokën nga dhoma, veprim që nënkuptonte asgjë më shumë e asgjë më pak se "mbledhje", nga e cila Anita dilte përherë e poshtëruar, e ulur dhe e fyer.

– Të kam parë atë ditë poshtë hyrjes së pallatit me atë. Të pashë me sytë e mi. Pas gjithë asaj që ke bërë, guxon dhe e takon përsëri?! Të larguam nga shkolla për një vit me një

mijë e një mashtrime e raporte të kota, sikur ke këtë apo atë sëmundje, për të të mbrojtur nga vetja jote, nga pafytyrësia dhe degjenerimi yt, që askush të mos të tregonte më me gisht në rrugë, dhe ti e takon përsëri? Si guxon qoftë edhe pak? – tha ajo, teksa iu afrua dhe e goditi me shuplakë.

– Nuk është e vërtetë, – tha Anita. – Të betohem për atë Zot!

– Do të shkosh në shkollë dhe do të kthehesh në shtëpi. Këtë do bësh çdo ditë derisa të mbarosh maturën. Pastaj, në rastin e parë që të vijë, cilido qoftë ai, sido që të jetë, do të fejohesh. Do të dalësh nga kjo shtëpi si nuse, siç të kemi edukuar ne, dhe jo si një lavire rrugësh siç do ti. Nëse ndihesh sadopak e tillë, qoftë edhe një grimcë të vetme, ma thuaj, dhe je plotësisht e lirë të dalësh që tani e të zhdukesh nga jeta jonë. Vendos vetë! – i tha.

Ndërsa i ati, për një vit, nuk i pati folur fare, madje nuk e kishte parë në sy as edhe një herë të vetme. Shpeshherë, kur binte të flinte, dëgjonte nga dhoma tjetër grindjet e tij me të ëmën, se si ata fajësonin njëri-tjetrin për atë që kishte ndodhur, se si duhet të kishin bërë këtë apo atë, ta pengonin të dilte nga shtëpia, të mos e kishin llastuar shumë. Ia kalonin fajin herë njërit e herë tjetrit dhe, në përfundim, arrinin në konkluzionin se nuk ishte gjë tjetër veçse "farë e keqe" fëmije, dhe pyesnin veten të dy se kujt mund t'i kishte ngjarë.

Anita dëgjonte gjithçka, bashkë me të motrën, e cila ishte e vogël dhe nuk e kuptonte të vërtetën dhe arsyen e asaj që po ndodhte, por e dinte se e motra kishte nevojë për të, për përqafimin e saj të ngrohtë.

– Pse janë kaq të mërzitur me ty? – pyeti një herë e vogla.

– Do ta kuptosh kur të rritesh, – tha Anita.

Përballë njëri-tjetrit, ajo dhe gjyshi, me shikimin secili nga dritarja, pa thënë asnjë fjalë të vetme, si një pakt i fshehtë mes tyre, në mënyrë që secili të rrinte vetëm dhe i patrazuar me mendimet e veta.

– Kam nevojë ta shikoj edhe një herë, – pati thënë një natë Anita, ashtu papritur, pasi kishin ngrënë darkën dhe e ëma po mblidhte tavolinën.

Të gjithë e panë në heshtje, ndërsa i ati e shikoi ashpër në sy, duke kapërdirë edhe një herë fjalët që donte të thoshte.

– Nuk mundem më, dua ta shoh edhe një herë, të më bjerë shpirti rehat sa ta shoh që është mirë, – tha ajo, dhe një lëmsh iu mblodh në grykë.

Heshtje, asgjë më shumë. Ishin të lodhur nga gjithçka: nga fjalët e tepërta që nuk të çonin askund, nga fajësimi i ndërsjellë dhe pseudo-harmonia tashmë e zhdukur në atë shtëpi, të lodhur nga iluzioni i mefshtë se dita e nesërme do të fshinte qoftë edhe pak të vërtetën e hidhur dhe turpin

që mbart me vete ajo që ndodh kur njeriu fik trurin për pak minuta.

– Do shkojmë bashkë, shpirti i gjyshit, – tha plot dhembshuri dhe, me dorën në krah, i vetmi njeri në atë shtëpi i cili, pavarësisht nga çdo gjë, nuk arrinte të ndiente për të asgjë tjetër veçse dashuri.

I ati ktheu kokën nga ana tjetër, si në pafuqi për të kundërshtuar në atë moment.

"I pafuqishëm" ishte termi i duhur, në fakt, nëse nuk ka ndonjë fjalë tjetër për atë që mund t'i bëjë një prindi sjellja e gabuar e fëmijës së vet. "Ç'të bën fëmija, s'ta bën as Perëndia" pat thënë një i mençur.

Ajo duhet të mbushë dy vjeç edhe pak muaj… Sa duhet të jetë rritur nga hera e fundit? E zhytur në mendime dhe e përkundur nga lëvizjet e trenit, Anita përpiqej të imagjinonte imazhin e vajzës së saj të vogël.

Ishte mars kur ajo lindi, në maternitetin e Lezhës. Larg nga zhurma e kryeqytetit, në mes të të panjohurve, ajo dhe e ëma. Falë njohjeve të së ëmës, u patën regjistruar nën një emër të rremë dhe ishin siguruar që asgjë të mos merrej vesh. Menjëherë pasi të kishte lindur, fëmija do të shoqërohej në brefotrofin e qytetit, pa i vënë një emër. Asgjë. Thjesht një anonim i humbur në një qytet me plot të panjohur, një fëmijë pa një të kaluar, pa identitet dhe pa

atësi, me shpresën se fati do të ishte i dhembshur me të dhe se do të gjendej diku një familje që do ta adoptonte. Dikush që do t'i jepte atë që Anita nuk ishte gati t'ia jepte; ndoshta dikush që po i lutej Zotit prej vitesh për një fëmijë dhe nuk kishte zgjedhje tjetër për t'i dhënë kuptim jetës veçse të merrte në gji mëkatin e saj.

Ndoshta ajo duhet të ketë lindur me fat, ndoshta do të jetë e lumtur në familjen e saj të re. Një nënë me shpirtin e vrarë mund t'i japë gjithë dashurinë e botës… e pastaj, ashtu si pa pritur, mendonte se mund të ndodhte edhe e kundërta. Pas së gjithash, ishte mjaftueshëm e rritur për të kuptuar se fati, në përgjithësi, nuk ishte shumë bujar me vajzat. Sikur të paktën të kishte lindur djalë, do të rritej e do të bëhej zot i vetes. Por një vajzë ishte ndryshe, krejt ndryshe. Lindja pati qenë shumë e vështirë. Një ditë e gjysmë e zhytur në dhimbje dhe agoni, duke u lutur në heshtje që ta merrte Zoti më mirë me vete. E mbytur në djersë dhe në frymëmarrje të sforcuara, me të ëmën që i rrinte te koka, diku nga ora dy e mëngjesit, si çdo gjë tjetër në këtë botë që vjen fiks në momentin e caktuar, bebja vendosi të lindte. Anita shtyu me gjithë forcën që i kishte mbetur, u lëshua në shtrat dhe i ra të fikët. E ëma, e tmerruar, u përkul tek e bija me shpresën ta sillte në vete, ndërsa dy infermiere të tjera i rrinin te koka; një e tretë mbante foshnjën në krah.

– Është vajzë, – i tha ajo të ëmës.

E ëma uli kokën dhe qau me dënesë, teksa e bija po hapte sytë. I puthi ballin dhe i shtrëngoi fort dorën.

– Mbaroi gjithçka, shpirt, mbaroi, shpëtove."

Anita ishte e humbur, si një njeri që rastësisht kishte marrë kthesën e gabuar në jetë.

– Të lutem, për atë që ke më të shenjtë, ma sill këtu afër, – i tha ajo infermieres që e mbante në krah.

Ajo, e hutuar, hodhi sytë nga e ëma. Kjo e fundit, me njërën dorë të mbështetur në ballë, uli kokën dhe shpërtheu në vaj, ndërsa me tjetrën bëri një gjest të vakët, sikur po jepte leje; një leje e rëndë, e nxjerrë mes dhimbjes dhe dorëzimit.

Sapo ia vendosën beben afër, sytë e Anitës u hapën krejt papritur, sikur gjaku filloi të rridhte përsëri në trupin e saj dhe shkëlqimi iu rikthye si dielli pas stuhisë.

Ishte një bebe e vogël, e urtë dhe me ca vetulla si të vizatuara.

Ishte veç një çast, një i vetëm dhe pastaj ia morën sërish, sepse kështu e kërkonte pakti me të ëmën. Kështu duhej shuar gjëma; rrugë tjetër nuk kishte. Ishte tepër vonë për një marrëveshje tjetër.

Tashmë ato të dyja, si bashkëfajtore në një heshtje të rëndë, nuk kishin më kthim pas as majtas, as djathtas. Vetëm përpara, drejt asaj që kishin peshuar e ripeshuar njëqind

herë, derisa vendimi ishte bërë i pashmangshëm. Askush nuk duhet ta dinte; ajo vetë duhej ta harronte. Të harronte që e kishte mbajtur nëntë muaj në bark, të harronte kush ishte i ati, por mbi të gjitha të harronte jo dhimbjet e lindjes, të cilat e ndiente se, thellë-thellë, i meritonte, por imazhin e saj, zërin dhe, mbi të gjitha, aromën e saj.

Gjyshi ishte i vetmi që fliste me të pa gjykim. Një herë, pasi kishin ngrënë darkën në heshtje, i tha me zë të ulët:

– A e kupton, nuk kemi përballë një mendje, por një zemër që digjet? Nuk është qenie logjike, është nënë,. dhe zemra e një nëne nuk njeh arsye.

Ishte më e lehtë të flisje me të sesa me të shoqin, pasi ai kishte gjithmonë një shpjegim apo një arsye për çdo gjë, aq sa ishte e pamundur të mos e ndiqje këshillën e tij. Ai nuk ishte thjesht si një baba për të gjithë në atë shtëpi; ai ishte shtylla, mendja dhe forca e secilit.

Dikur kishin qenë shumë të pasur, pasi i ati merrej me tregti në Austri, por pas ardhjes së regjimit komunist u detyruan të humbnin gjithçka. I ati vdiq nëpër burgje duke tentuar të mbronte pronën e tij, ndërsa ai, që atëherë ishte 14 vjeç, filloi të punonte marangoz në ndërmarrjen e përpunimit të drurit dhe zgjodhi të maskohej si një njeri i rëndomtë dhe i lumtur. Por ishte i qetë, tmerrësisht i qetë, dhe kishte bindjen e plotë se lufta e mbijetesës arrihej vetëm

nga një armë e vetme që quhej "elasticitet" dhe se asnjë krijesë nuk do të mbijetonte nëse nuk mëson të përshtatet me kushtet e jashtme, jo më njeriu.

– Ajo që ka ndodhur nuk zhbëhet, moj bijë. Duhet vetëm të gjejmë mënyrën që ta përballojmë ashtu si duhet. Do të vazhdojmë të gënjejmë dhe të mashtrojmë. Unë do ta çoj të shohë të bijën, se është zemër nëne edhe ajo. Do të vijë momenti kur nuk do të kërkojë më, pasi do të ketë krijuar familjen e vet e do të ketë fëmijë të tjerë. Por, derisa të vijë ai moment, duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

Diku nga fundi i qershorit, atëherë kur shoqet e saj mendonin vetëm për pushimet e verës dhe diskutonin se sa i lodhshëm kishte qenë ky vit shkollor, Anita dëgjonte në heshtje, me mendjen vetëm në një vend.

– E ke akoma atë fustanin bojëqielli me rrip në mes, atë që ta pati qepur tezja vjet? – pyeti, si krejt jashtë teme, Dritën, shoqen e saj.

– Po, – tha ajo, e habitur nga pyetja.

– Nuk e di… hmm… nëse do ma jepje për dy ditë, ta marr si model, nëse nuk e ke problem – pyeti Anita, si e zënë në faj.

– Po. – tha ajo, e çuditur se si një fustan mund të ishte kaq i vështirë për t'u kërkuar borxh.

E vërteta ishte se asaj i duhej ai fustan për të takuar të

bijën. Nuk donte të dukej e lëshuar dhe e pambajtur, edhe pse muajt e fundit nuk e shihte dot veten në pasqyrë.

E veshur me fustanin bojëqielli dhe me gjyshin për dore, zbritën nga treni. Duhej një copë e mirë rruge në këmbë deri te brefotrofi i qytetit. Duart po i djersiteshin, zemra i rrihte fort dhe në çdo hap sikur nuk ngopej mjaftueshëm me frymë, kur, pa e kuptuar, mbërritën në një godinë dykatëshe ngjyrë gri. Trokitën në derë dhe një zonjë, që me shumë gjasa ishte pastruese, hapi derën një pëllëmbë.

– Urdhëroni! – tha ajo, si e trembur.

– Të lutem, a mund të më lajmëroni zonjën Marika? Është urgjente, thuaji, – tha Anita me padurim.

Pastruesja pohoi me kokë dhe mbylli derën.

U deshën pesëmbëdhjetë minuta që Marika, një zonjë mbipeshë me flokë të shkurtra, rreth të pesëdhjetave, të dilte te dera.

– Ja… jam Anita. Kam qenë edhe një… dy herë të tjera, nëse mban mend; madje herën e fundit u takuam bashkë. Kam vajzën këtu. Kam ardhur ta takoj përsëri, të lutem, – tha Anita, teksa fjalët i humbnin papritmas, ndërkohë që gjyshi rrinte në heshtje dhe shtrëngonte kapelën në dorë, në shenjë nervozizmi. Marika, me shikimin e ngulitur tek ajo, në përpjekje për të kuptuar çfarë po thoshte kjo vajzë, u kthjellua në një moment dhe u kujtua për kë bëhej fjalë.

– Oh, zemër, më vjen keq, vajza juaj është birësuar tashmë", – tha ajo plot dhembshuri.

Anita e humbi veten. Nuk mundi ta kuptonte; gjithçka iu duk e pamundur dhe aspak reale, si një film pa zë. Pa dëgjuar asnjë fjalë të vetme, shihte që Marika lëvizte buzët, diçka thoshte, vazhdonte të fliste, por Anita nuk dëgjonte më asgjë. U ngrinë në vend dhe kaq. Në çast, gjyshi iu afrua dhe u përpoq ta përqafonte të tërën, por në atë moment ajo shpërtheu, sikur informacioni që sapo mori i arriti në tru, dhe filloi të qante pafund, e rrëzuar në gjunjë te dera e brefotrofit të Lezhës.

E morën dhe e futën brenda; nuk ishte vetvetja në atë moment. Marika i bëri një gotë me ujë e sheqer dhe pastruesja i fërkonte shpatullat që të vinte në vete, ndërsa gjyshi, te cepi i dhomës, ishte kthyer me shpinë, i turpëruar që po qante edhe ai si një fëmijë. Qëndruan aty për një orë të tërë, derisa gjyshi u kujtua se duhet të merrnin trenin e kthimit. E mori për dore dhe dolën. Ajo nuk ishte më e gjallë. Një trup pa shpirt lëvizte në heshtje, duke hedhur hapat një nga një, pa e ditur se nga ecte.

U ulën në tren. Ajo mbështeti kokën te gjoksi i gjyshit dhe vajtoi, vajtoi derisa nuk kishte më fuqi.

Në shtëpi, derën e hapi e ëma, e cila kërkonte me shikim një kuptim për gjithçka. Anita u turr drejt derës së dhomës së saj, nga ku nuk doli deri të nesërmen në darkë.

Nuk e shqetësuan më, me idenë se edhe kjo dhimbje duhet jetuar në një mënyrë dhe se, pasi të kishte kaluar ciklin e vet, si çdo gjë në këtë botë, do të kalonte.

E ëma u ul në kuzhinë dhe, me zë të ulët, gjyshi i shpjegoi gjithçka.

– Mbaroi, – i tha ai me besim të plotë se gjithçka do të rregullohej. – Tani duhet ta qetësojmë dhe, pasi të kalojë kjo periudhë, të mendojmë seriozisht ta martojmë. Do të krijojë familjen e vet dhe do të kalojë gjithçka; vetëm duhet të kemi durim.

Ajo e shikonte plot dyshim, edhe pse kishte nevojë të kapej pas një shprese, pas një ideje se mund të rregullohej edhe lëmshi më i madh dhe se gjithçka do të mbetej, për aq kohë sa të ishte e mundur, e fshehtë. Gjithçka do të rregullohej, pa dyshimin më të vogël! Më e keqja kishte ikur tashmë. Ajo nuk do ta kërkonte më të bijën, pasi nuk dihej ku kishte shkuar; nuk mund ta merrte vesh, edhe sikur të donte.